



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.100/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Adnan Konushevcu dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013 për “Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike”, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 27.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet e bazuar ankesa e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, Anr.100/2019 e datës 26.09.2017, ndërsa subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 2.600 (dymijë e gjashtëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në PZAP më datë 26.09.2019, me të cilën pretendon se më datë 25 shtator 2019, rreth orës 19:00, kandidatja për kryeministre nga radhët e subjektit politik LDK është parë bashkë me vajzat e saj në tubimin hapës të fushatës zgjedhore, ku ndër të tjera vajzat e kandidatës për kryeministre të Kosovës kishin të vendosur materiale zgjedhore në veshjet e tyre. Sipas paraqitësit të ankesës ky veprim i kandidatës në fjalë bie në kundërshtim me Rregullën Zgjedhore Nr.13/2013 për “Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike”, respektivisht nenin 5, pikën 2 të kësaj rregulle.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ankuesi ka bashkangjitur një fotografi të kandidatës për kryeministre të Kosovës Vjosa Osmani bashkë me vajzat e saj.

Në përgjigjen në ankesë, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të datës 27.09.2019, thekson se pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën Anr.100/2019, të datës 26.09.2019, nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, janë të pabazuara, duke shtuar se është i vërtetë fakti se kandidatja për kryeministre të Kosovës Vjosa Osmani, ka qenë në tubimin hapës të fushatës zgjedhore bashkë me vajzat e saj por që kjo nuk ka të bëjë me përfshirjen e personave të cilët nuk i kanë mbushur 18 vjet në Ditën e Zgjedhjeve. Subjekti politik në fjalë i ka kundërshtuar pretendimet e paraqitësit të ankesës për dy arsye: fillimisht sepse vajzat e kandidatës Osmani janë pjesë e familjes Osmani gjë e cila nënkupton se kandidatja për kryeministre para masës dhe elektoratit ka prezentuar me bashkëshortin dhe

vajzat e saj që nuk nënkupton se fëmijët kanë qenë të përdorur për fushatë pasi që kanë qenë të shoqëruar nga prindërit e tyre si kujdestarë. Së dyti ka bërë një krahasim me zgjedhjet presidenciale, në fushatën hapëse dhe mbyllëse elektorale të zhvilluar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në vitin 2008 dhe 2012, në të cilën fushatë ish Presidenti Obama ka prezentuar bashkë me bashkëshorten dhe dy vajzat e tij. Në fund ka kërkuar nga PZAP-i, që ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova me seli në Prishtinë, ta hudhë si të palejuar.

Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tij, subjekti politik LDK, i ka bashkëngjitur disa foto të ish Presidentit Obama bashkë me bashkëshorten dhe vajzat e tij.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar,

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se kandidatja për kryeministre të Kosovës nga radhët e subjektit politik LDK, në tubimin e fushatës zgjedhore ka qenë e shoqëruar nga vajzat e saj e të cilat në veshjet e tyre kishin të vendosura materiale promovuese të subjektit politik LDK, veprim ky që është në kundërshtim me Rregullën Zgjedhore Nr.20/2019 të datës 26.09.2019, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, për “Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike”, respektivisht nenin 2 par.3, pika b), c) dhe d) të kësaj rregulle, e cila dispozitë përcakton se: “ ... *asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të përfshinë personat të cilët nuk i kanë mbushur 15 vjet në veprimet e mëposhtme: ...; b) bartin pankarta dhe materiale tjera promovuese gjatë aktivitetit të fushatës zgjedhore; c) të jenë pjesë aktive e materialeve promovuese politike për të shmangur etiketimin e mundshëm, ngacmimin dhe çfarëdo ndikimi tjetër negativ të tyre; d) të jenë pjesë aktive e materialeve promovuese politike në fushatë zgjedhore me qëllim për të marrë vota emocionale të elektoratit*”. Andaj duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), është shkelur Rregulla Zgjedhore Nr.20/2019 e datës 26.09.2019, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, për “Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike”, pasi që nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës vërtetohet se vajzat e kandidatës për kryeministre të Kosovës nga radhët e LDK-së, Vjosa Osmani, kategorizohen në radhën e personave nën moshën 15 vjet dhe të njëjtat në tubimin e fushatës zgjedhore në veshjet e tyre kanë bartur material promovues për subjektin politik LDK.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë; si dhe

- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se është njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe përkundër këtij fakti nga ana e këtij subjekti gjatë aktivitetit të fushatës zgjedhore janë përdorur personat nën moshën 15 vjet dhe atë edhe duke mbartur në veshjet e tyre material promovues të subjektit politik LDK, gjë e cila është në kundërshtim me dispozitat e lartëcekura ligjore.

Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, iu dha mundësia për tu përgjigjur në ankesë dhe ta pranojë shkeljen e bërë, mirëpo subjekti politik nëpërmes përgjigjes në ankesë shihet qartë se nuk e ka pranuar shkeljen dhe për më tepër ka deklaruar se ky veprim i tyre nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore, veprime këto të cilat kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa

Anr.100/2019 më datë 27.09.2019

Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 rreth të LZP-së.